



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 30, datë 24.03.2020

“PËR

AMENDIMIN E KONTRATËS TË SHËRBIMIT TË PASTRIMIT ME BASHKIMIN E OPERATORËVE “ANTE GROUP” DHE “GJIKURIA” SHPK PËR ZONËN TIRANA 1 NË KUADËR TË MARRJEVE TË MASAVE GJATË KOHËZGJATJES SË PERIUdhËS SË INFEKSIONIT TË SHKAKTUAR NGA COVID-19”

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 24, nenit 29, pika 1, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 5/1 të Aktit Normativ nr. 3, datë 16.03.2020 të Këshillit të Ministrave “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga covid-19”, të ndryshuar, Ligjit nr.15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Miratimin e amendimit të kontratës nr.5114/6 prot, datë 03.04.2018 të shërbimit të pastrimit të Zonës Tirana 1 të diktuar nga situata emergjente me bashkimin e operatorëve “Ante Group” dhe “Gjiguria” shpk, në kuadër të marrjeve të masave gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19, sipas aneksit nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Amendimi i kontratës të cituar në pikën 1 të këtij vendimi, ka të bëjë me shtimin e frekuencës për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave urbane dhe larja dhe dezinfektimi i kontenierëve në funksion të pastrimit të Zonës Tirana 1, si masë për parandalimin e përhapjes së infeksionit të COVID-19.
3. Shpenzimet mbulohen nga buxheti i Bashkisë Tiranë për vitin 2020 të miratuara për këtë qëllim.
4. Amendimi i kontratës sipas këtij vendimi nënshkruhet nga zëvendëskryetari i bashkisë në cilësinë e autoritetit kontraktor të Bashkisë Tiranë.

